

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400-34487 më 20.06.2016

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. **Nexhat Demaku**

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 10.06.2016

1. Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Drenasit
2. Rishqyrtimi i vendimit Nr.400-24671 i datës 03.05.2016
3. Vendimi për ndryshimin e taksës ndërtimore
4. Vendim për dhënien në shfrytëzim aneksi i Komunës së vjetër për promovimin e drejtave të Grave të Komunës së Glllogocit
5. Vendimet për dhënien e pronave në shfrytëzim
 - A) Vendimi i firmes përfituese B.B
 - B) Vendimi i firmes përfituese N.P.SH "Thaqi"
 - C) Vendimi i firmes përfituese "Valdrini" SH.P.K

Drenas
20.06.2016



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit(Gllogoc)



Kuvendi i Komunës
Nr. 400-344⁰⁷ dt. 20.06.2016

Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- Z. Naim Bazaj



Për: Kryetarin e Komunës z.Nexhat Demakun

LËNDA:Dërgimi i akteve te miratuara nga Kuvendi i Komunës se Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 10.06.2016

1. Rregulloren komunale për menagjimin e mbeturinave në komunën e Drenasit
2. Ryshqyrtimi i vendimit Nr.400-24671 të dt: 03.05.2016
3. Vendim për ndryshimin e taksës ndërtimore
4. Vendim për dhënjën në shfrytezim aneksi i Komunës së vjetër për promovimin e drejtave të Grave të Komunës së Gllogocit
5. Vendimet për dhënjën e pronave në shfrytezim
 - A) Vendimi i firmes Përfituse B.B
 - B) Vendimi i firmes Përfituse N.P.SH "Thaqi"
 - C) Vendimi i firmes Përfituse Valdrina "SH.P.K"

Më dt:20.06.2016

Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Gllgocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400 - 33981 dt 17.06.2016

Duke u bazuar ne nenin 12 pika c si dhe të nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale , nenit 15 paragrafi 7, nenit 34 paragrafi 2 dhe 7 të Ligjit nr. 04/L-60, për mbeturina (GZRK, nr. 17/2012), 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me dt:10.06.2016 miratoi këtë:

RREGULLORE
KOMUNALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E DRENASIT

NENI 1
QËLLIMET DHE DETYRAT

- 1.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të rregullojë çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë të integruar, për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave
- 1.2 Me këtë rregullore krijohen kushtet për e menaxhimin e integruar dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar të mbeturinave dhe uljen e shkallës së rrezikshmërisë nga mbeturinat

NENI 2
PËRKUFIZIMET

1. Përveç shprehjeve të përdorura në ligj sipas kësaj rregulloreje kemi edhe këto përkufizime:
 - 1.1 Qendër grumbulluese – lokacioni për pranimin përkatësisht grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara nga qendra
 - 1.2 Pikë grumbulluese – lokacioni ku janë të vendosur shportat, kontejnerët dhe qeset/thasët për grumbullimin e mbeturinave komunale

NENI 3
LLOJET E MBETURINAVE

1. Llojet e mbeturinave që menaxhohen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje janë:
Mbeturinat komunale:
 - 1.1 Mbeturina Komunale - janë mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera te cilat për shkak te përbërjes dhe natyrës tyre mund të janë te ngjashme me ato te amvisërisë
 - 1.2 Mbeturina inerte, që nuk tretën, nuk ndizen dhe nuk kanë si pasojë reagime fizike ose kimike, që nuk kanë zbrëthim biologjik në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut
 - 1.3 Mbeturina të vëllimshme, mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mobiljet;

- 1.4 Mbeturina nga konstruktim-demolimet dhe mbeturinat tjera të gjeneruar nga aktivitetet ndërtimore
- 1.5 Bio-mbeturinat – mbeturinat e biodegradueshme nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit
2. Mbeturina komerciale: janë mbeturinat të cilat gjenerohen nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit por që nuk përfshihen në mbeturina industriale
3. Mbeturina industriale të përcaktuara sipas Ligjit
4. Mbeturina medicinale, humane, dhe veterinare, dhe mbeturinat nga produktet medicinale (barnat e përdorura dhe me afat të skaduar)
5. Mbeturina shtazore të cilat krijohen nga amvisëritë, mishtoret, therrëtoret dhe aktivitetet tjera të ngjashme.

NENI 4 PËRJASHTIMET

1. Nga kjo Rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
 - 1.1 Mbeturinat e rrezikshme, dhe
 - 1.2 Llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme.
2. Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme rregullohet në bazë të Ligjit dhe akteve tjera ligjore përkatëse.

NENI 5 PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS MBI MENAXHIMIN E MBETURINAVE

- 5.1 Themelimi i sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, (emërimi i një zyrtari/ët përgjegjës) në kuadër të Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE) që të planifikojë, rregullojë, udhëheqë dhe të implementojë aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave brenda territorit të komunës së Drenasit, si dhe të udhëzojë, monitoroj ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
- 5.2 Menaxhimi i mbeturinave komunale nga konstruktim – demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme, dhe të ngjashme
- 5.3 Përcaktimi i lokacionit për qendrën grumbulluese për mbeturinat e vëllimshme, dhe mbeturinat elektrike dhe elektronike (afati kohor më së largu 24 muaj, nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje). Deri në funksionalizim të qendrës, DSHPE cakton një qendër të përkohshme grumbulluese me vendim të Kuvendit Komunal-Drenas.
- 5.4 Qendra grumbulluese për mbeturinat e vëllimshme, dhe mbeturinat elektrike dhe elektronike duhet të plotësojnë kushteve dhe kriteret e përcaktuara me Ligj dhe aktet nënligjore
- 5.5 Përcaktimi i hartës/lokacioneve për vendosjen e kontejnerëve komunal bëhet nga DSHPE-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit

(DUPMM)

- 5.6 Përcaktimi i llojit të kontejnerëve të përshtatshëm me teknikën me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i tyre.
- 5.7 Përcaktimi i orarit dhe dinamikës së mbledhjes së mbeturinave mbetet ai aktual deri në një vendim të ri, të nxjerrur nga DSHPE
- 5.8 Sipas nevojës, për interesin publik, DSHPE-ja autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë
- 5.9 DSHPE dhe DI i Identifikimi i pikave dhe deponive ilegale të mbeturinave dhe eliminimi i tyre
- 5.10 DSHPE-ja shqyrton ankesat e klientëve të saj sa i përket shërbimit për grumbullim të mbeturinave
- 5.11 Promovimi i konceptit për minimizim të mbeturinave (3R - Reduktimi, Ripërdorimi, dhe Riciklimi)
- 5.12 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm (si pas Planit Komunal) mbi menaxhimin e mbeturinave komunale.
- 5.13 Përpilimi i raporteve mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të tarifës mbi mbeturinat.
- 5.14 Dorëzimi i raportit vjetor në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për menaxhim të mbeturinave çdo 31 mars të vitit pasues.
- 5.15 Monitorimi dhe hartimi i raportit vjetor për implementimin e Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, deri më 31 mars të vitit vijues.

NENI 6

KATEGORIZIMI I GJENERUESVE TË MBETURINAVE

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

1. Konsumatorët e amvisërive:
 - 1.1 Të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët
 - 1.2 Të shërbyer me shërbimin derë më derë
1. Konsumatorët komercial/industrial:
 - 2.1 Dyqanet e vogla Zejtare dhe Shërbyese
 - 2.2 Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit
 - 2.3 Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit
 - 2.4 Subjektet e mesme deri të mëdha komerciale / industriale me kosto të lartë të shërbimit
 - 2.5 Konsumatorët e shërbyer me kontrata të veqanta për zbrazje
2. Institucionet:
 - 3.1 Konsumatorët e vegjël institucional
 - 3.2 Konsumatorë e mesëm dhe të mëdhenj institucional
 - 3.3 Konsumatorët e mëdhenj institucional të shërbyer me kontratë

NENI 7

TARIFA PËR GRUMBULLIM, TRANSPORTIM DHE DEPONIM TË MBETURINAVE

1. Komuna i cakton tarifat për mbeturinat, varësisht nga lloji i tyre, në bazë të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.
2. Arkëtimit të tarifave të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, do ta bëjnë Operatorët Ekonomik pas kryerjes së shërbimeve të caktuara në kontratë mbi kryerjen e shërbimeve të lidhura me mesazhet operatorve ekonomike dhe gjeneruesve të mbeturinave.

Përcaktimi i tarifave të shërbimit është me ankesë shtesë.

NENI 8

TË DREJTAT DHE DETYRAT E GJENERUESVE TË MBETURINAVE

- 8.1 Gjeneruesit e mbeturinave duhet të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së mbeturinave
- 8.2 Të gjithë personat fizik dhe juridik që krijojnë mbeturina, duhet të kenë qasje në shërbimet publike për grumbullimin e mbeturinave.
- 8.3 Gjeneruesit e mbeturinave detyrohen që fraksionet e mbeturinave t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna (poashtu edhe përmes kompostimit dhe formave tjera të mundshme).
- 8.4 Gjeneruesit e mbeturinave detyrohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme (nga amvisëritë, t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në pikat grumbulluese).
- 8.5 Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektojë rregullat dhe orarin e hedhjes së mbeturinave të përcaktuar nga operatori më përparim të Komunës.
- 8.6 Çdo gjenerues i mbeturinave komunale ka të drejtë ankese ndaj shërbimit të ofruar (komforti neni 5, pika 5.10)
- 8.7 Çdo gjenerues i mbeturinave në zonën e shërbimit preferohet - obligohet të jetë pjese e shërbimit
- 8.8 Ndërmarrjet industriale të cilat gjenerojnë mbeturina gjatë ushtrimit të veprimtarisë obligohen që Komunës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave.

NENI 9

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E OPERATORËVE TË KONTRAKTUAR PËR SHËRBIMIN E MBETURINAVE

- 9.1 Operatori i kontraktuar nga Komuna, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

NENI 10

VEPRIMET E NDALUARA

1. Përveç veprimeve të ndaluara, të parapara me Ligj dhe akte tjera nënligjore, me këtë rregullore ndalohen edhe veprimet si më poshtë:
 - 1.1 Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve shumë banesore;
 - 1.2 Shfrytëzimi i mbeturinave nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme;
 - 1.3 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”;
 - 1.4 Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej mjeteve transportuese gjatë grumbullimit dhe transportimit të tyre nga personat fizik dhe juridik;
 - 1.5 Transportimi i mbeturinave, me mjete transportuese pa mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave;
 - 1.6 Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër.

NENI 11

GJOBAT

Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, për veprimet e ndaluara, Neni 10, (pikat 1.1, 2,3,4,5) inspektori komunal, zyrtari policor, shqipton gjobë mandatorë prej 50 euro, përveç pikës 6 deri në 200 euro

NENI 12

MBIKËQYRJA DHE INSPEKTIMI

1. Autoritet kompetente për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje është Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtorati për Inspektoratit Komunal dhe Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
2. Inspektimin e bënë inspektori mjedisor i komunës, personi i autorizuar dhe policia e Kosovës.

NENI 13

Dispozitat kalimtare dhe të fundit


Në rast se dispozitat e kësaj rregulloreje bien ndesh me ligjin për mbeturina, epërsi do të kenë dispozitat ligjore.

NENI 14
Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e rregullores 16 nr. 501-1768 të dt. 27.12.2012 për menaxhimin e mbeturinave komunale që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe ligjit për mbeturina dhe aktet tjera nënligjore.

NENI 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për administrimin e Pushtetit Lokal si dhe 8 ditë pas publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës së Drenasit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 400 - 33980 dt 17.06.2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 e lidhur me nenin 82.2 të Ligjit nr. 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale ,Kërkesës nr.020/748 te datës 16.05.2016 për rishqyrtimin e Vendimit te Kuvendit të Komunës se Gllogocit ,nr.400-24671 të datës 03.05.2016 te Ministris se Administrimit të Pushtetit Lokal , nenit 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1. 2 dhe nënparagrafit 1.4 të Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënjen në shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës të Drenasit , ne mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt.10.06.2016 miratoj këtë:

VENDIM

Neni I

Për dhënjen në shfrytëzimt afatgjatë për 99 vite të pjesës së ngastrës kadastale nr.780 me kulturë Kullos kl.5 në vendine quajtur "Llazina-Llazina" zona kadastrale Tërstenik në sipërfaqe prej S=0.80.00 ha për ndërtimin e kishës protestante si dhe lokacion per varreza për nevoja të komunitetit protestant, palujtshmëria është pronë Komunale e Komunës së Drenasit .

Neni II

Obligohet Drejtorati për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit që të jap pëlqimin për lokacionin e ndërtimit të Kishës dhe varrezave .

Neni III


Obligohet Drejtorati për Kadastrës , Gjeodezi dhe Pronë të bënë bartjen e kësaj palujtshmërie në emër të shfrytëzuesit në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në regjistrin e RDPP në emër të Bashkesia Ungjillore e Mesise ne Prishtine .

Neni IV

Me këtë vendim do të njoftohen : Drejtoratet e Komunës së Drenasit.

Neni V

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-33977 dt 17.06 2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal,nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim,nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2012 mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit, Pëlqimit nr.369-2 të datës 16.02.2016 për zbatimin e Taksës administrative për Lejet e Ndërtimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë dhe nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit,Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e mbajtur me dt: 10.06.2016 miratoj këtë

V E N D I M
PËR APROVIMIN E TAKSËS ADMINISTRATIVE PËR LEJET E NDËRTIMIT PËR
VITIN 2016

Neni I

Me këtë vendim aprovohet taksa administrative për lejet e ndërtimit në territorin e komunës së Drenasit për vitin 2016 ,e llogaritur në lartësi prej 1.88€/

Neni II


Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale në territorin e Komunës së Drenasit për vitin 2016.

Neni III

Zbatimin e këtij vendimi e bëjnë Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit të , ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Drenas.

Neni IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasi,dhe vlersimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. *40-34429* dt *20.06* 2016

Në bazq të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 10 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 34pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe Kërkesës 01 Nr.360-2008 të datës 13.01.2016 të Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave lidhur me dhënien në shfrytëzim të një pjese të lokalit të Komunës së vjetër Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2016 miratoi këtë:

VENDIM

- I. IPET në shfrytëzim aneksi i Komunës së vjetër e atë pjesa veriore e këtij objekti Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave të Komunës së Glllogocit ,pa kompensim (Gratis) në afat kohor prej 10(dhjetë)vitesh, për zhvilliminin e aktivitetit të kësaj OJQ-sipas kërkeses të cekur në hyrje të këtij propozim vendimi dhe atë kati perdhese dhe kati i parë.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorati i administrates se pergjithshme. obligimet reciproke do të rregullohen me kontratë mbi dhënjen në shfrytëzim të këtij objekti që do të lidh Kryetari i Komunës me shfrytëzuesin.
- III. Më këtë vendim do të njoftohet Drejtorati i administrates se pergjithshme dhe arkivi.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit dhe vlersimit te ligjshmerisë nga MAPL-ja



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 463-34433 dt 20.06 2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144, nenit 34 pika 34.6 te Statutit të komunës Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) si dhe propozimit të komisionit për dhënjën e pronave në shfrytëzim nr.12 463-30345 në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2016 miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit Nr.12-463-30345 për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për përiudhen afatëgjate sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjën e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kriteret e konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive, çmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Ipet në shfrytëzim Prona e paluajtshme e Komunës me sa vijon:

- Emri i përfituesit: B.B
- Zona Katastrale :Komoran, parcela nr.1
- Vlera investive :200.000,00 €
- Numri i punëtorve : 9 vende pune
- Gjithësejt Sipërfaqja e pranuar :0.15 ha.
- Afati i shfrytëzimit të pronës është 45 vjet.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit që të jap pëlqimin për lokacionin e caktuar

Neni 5


Obligohet Drejtorati për Kadastrës, Gjeodezi dhe Pronë të bënë bartjen e kësaj palujtshmërie në emër të shfrytëzuesit në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite në regjistrin e RDPP në emër të firmes kontraktuse B.B Komoran

Neni 6

Obligohet Kryetari i Komunës që pas hyrjes në fuqi të keti vendimi të lidh kontrat me firmen përfituese

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi i Komunes dhe vlersimi i MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 463-34432 dt 20.06.2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të komunës Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) si dhe propozimit të komisionit për dhënjën e pronave në shfrytëzim nr.12 463-30345 në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2016 miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN E PRONES SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit Nr.12-463-30345 për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për periudhën afatgjatë sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjën e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kriteret e konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive, çmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Ipet në shfrytëzim Prona e paluajtshme e Komunës me sa vijon:

- Emri i përfituesit: N.P.SH "Thaqi"
- Zona Katastrale :Komoran, parcela nr.1574/3
- Vlera investive :30.000,00 euro
- Numri i punëtorve : 6 vende pune
- Gjithësejt Sipërfaqja e pranuar :0.15 ha
- Afati i shfrytëzimit të pronës është 45 vjet.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit që të jap pëlqimin për lokacionin e caktuar

Neni 5


Obligohet Drejtorati për Kadastrës, Gjeodezi dhe Pronë të bënë bartjen e kësaj paluajtshmërie në emër të shfrytëzuesit në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite në regjistrin e RDPP në emër të firmes kontraktuse N.P.SH "Thaqi"

Neni 6

Obligohet Kryetari i Komunës që pas hyrjes në fuqi të keti vendimi të lidh kontrat me firmen përfituese

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimi i MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj
Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 463 - 34434 dt 20.06.2016

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3 pika 1.4 si dhe nenit 6 të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës Ligjit Nr. 04/L-144, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të komunës Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) si dhe propozimit të komisionit për dhënjën e pronave në shfrytëzim nr.12 463-30345 Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2016 miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË

Neni 1

Aprovohet vendimi i komisionit Nr.12-463-30345 për ndarjen e parcelave të dhëna në shfrytëzim për periudhën afatgjatë sipas ligjit Nr.04/L-144 për dhënjën e tokave në shfrytëzim.

Neni 2

Ndarja e parcelave ka qenë në përputhje me ligjin për dhënjën e tokave në shfrytëzim Nr. 04/L-144 dhe kritereve të konkursit të shpallur në bazë të numrit të punëtorve, vlerës investive , çmimit të ofruar, dhe veprimtarisë që zhvillon.

Neni 3

Ipet në shfrytëzim Prona e paluajtshme e Komunës me sa vijon:

- Emri i përfituesit: "Valdrini "SH.P.K
- Zona Katastrale :Drenas,nr i parcelës 726/15
- Vlera investive :460.000,00 euro
- Numri i punëtorve : 6 vende pune
- Gjithësejt Sipërfaqja e pranuar : 1 ha e 22 ari
- Afati i shfrytëzimit të pronës është 45 vjet.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit që të jap pëlqimin për lokacionin e caktuar

Neni 5


Obligohet Drejtorati për Kadastrës , Gjeodezi dhe Pronë të bënë bartjen e kësaj paluajtshmërie në emër të shfrytëzuesit në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite në regjistrin e RDPP në emër të firmes kontraktuse "Valdrini" SH.P.K

Neni 6

Obligohet kryetari i komunës që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të lidh kontratë me firmën duke ju permbajtur vendimit të marrë në kuvend që të ruhet destinimi i sipërfaqeve dhe hapësirave të objektit ekzistues si: hapsirat pritjes, sportelat, peronat, të respektohet PZHK dhe urban i Drenasit për nenkalim si dhe të lirohet zona e rruges

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimi i MAPL-së



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Naim Bazaj
Naim Bazaj